



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 758/2 Prot.

Tiranë, më 27 / 05 / 2021

**V E N D I M**

**Nr. 90 , Datë 27 / 05 / 2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 91, datë 17.05.2021, të D. B kundër Bashkisë Berat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>” dhe “çdo shkak tjetër<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur, subjekti ankues është ankuar në mënyrë të përsëritur nga që nga viti 2018 e në vijim, pranë institucioneve të ndryshme si: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), Bashkia Berat, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Instituti i Ndërtimit, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DV ASHK) Berat, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Kontrollit i Lartë i Shtetit (KLSH), Policia Bashkiake/Bashkia Berat, për një ndërtim të paligjshëm mbi tarracën e banesës së saj.

Ankuesja shprehet se: “Në vitin 1997, kunati im R. B. ka ndërtuar mbi tarracën e banesës sime një ndërtim pa leje. Në vitin 2018, mbi objektin ekzistues ka bërë rikonstruksionin e banesës së

<sup>1</sup> Referuar Dëshmisë nr. 161, të Shoqatës së Invalidëve të Punës të Shqipërisë, me afat përdorimi një vjeçar (01.03.2021-01.03.2022).

<sup>2</sup> Ankuesja thjesht ka sigluar këtë shkak tek formulari i ankesës, pa dhënë asnjë shpjegim.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

*tij, duke futur materiale të rënda mbi banesën ekzistuese, e cila është e pamundur që të përballojë ngarkesën. Ka rrezikshmëri të lartë për shembjen e gjithë banesës dhe rrezikon në të njëjtën kohë edhe banesat përreth, siç ka konstatuar Instituti i Ndërtimit Tiranë, në rekomandimet e tij të Raportit Teknik për vlerësimin e situatës”.*

Sa më sipër, deri në momentin e paraqitjes së ankesës para KMD-së, ankuesja është shprehur se Bashkia Berat nuk ka marrë asnjë masë në zbatim të “Raportit Teknik/Mbi inspektimin në terren të objektit, banesë private në pronësi të z. A. B dhe D. B” të Institutit të Ndërtimit, i cili rekomandon masat që duhet të ndërmerren për zgjidhjen e kësaj problematike.

Në përfundim të parashtrimeve, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri: *“Të ndërhyjë që Bashkia Berat të zbatojë Vendimin e Raportit Teknik, të Institutit të Ndërtimit Tiranë dhe DV ASHK Berat”.*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen

nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur ankesës, rezulton se:*

Nëpërmjet shkresës me nr. 90/2 prot., datë 20.05.2019 të Institutit të Ndërtimit, “Raport Teknik/Mbi inspektimin në terren të objektit, banesë private në pronësi të A. B dhe D. B” , i është rekomanduar Bashkisë Berat:

- *“Të merren masa të menjëhershme për lehtësimin e peshave në strukturat mbajtëse të banesës.*
- *Heqja e objektit të ndërtuar sipër objektit ekzistues, i cili është shkaku kryesor i humbjes së qëndrueshmërisë së strukturave mbajtëse të banesës në pronësi të z. A B dhe D. B.*
- *Të hartohet një projekt nga strukturat vendore për stabilizimin e rrëshqitjes, për rehabilitimin e situatës së krijuar, e cila është emergjente, problematike që mund të çojë në kolaps gjithë shpatin dhe ndërtimet përreth tij.*
- *Të shikohet mundësia e evadimit të banorëve, si dhe atyre përreth, deri në zgjidhjen përfundimtare të situatës”.*

Nëpërmjet shkresës me nr. 2966 prot., datë 12.06.2020, DV ASHK Berat është shprehur lidhur me praktikën e legalizimit për objektin informal, në emër të R. B, i cili kishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme këtë objekt mbi banesën e ankuses, D. B.

Nëpërmjet Vendimit të Skualifikimit me nr. 3434, datë 12.06.2020, DV ASHK Berat ka vendosur që ndërtimi informal, sipërcituar, nuk i plotëson kriteret kualifikuese dhe për pasojë i nënshtrohet përjashtimit nga procesi i legalizimit.

Referuar këtyre dy akteve shkresore, sipërcituar, IMT, nëpërmjet shkresës me nr. 5107 prot., datë 03.11.2020, i është drejtuar IMT Berat/Bashkia Berat që të bëjë vlerësimin e situatës së banesës së ankuses dhe të sigurojë logjistikën e nevojshme me qëllim zgjidhjen përfundimtare të kësaj problematike.

IMT Berat/Bashkia Berat<sup>4</sup> lidhur me marrjen e masave për zgjidhjen e problematikës së ankuses, ka cituar se:

*“Me Urdhrin nr. 73, datë 02.02.2021, Bashkia Berat ka marrë masa për realizimin e kësaj detyre dhe ka nisur procedurën për krijimin e një grupi pune të përbërë nga specialistë të IMT dhe të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, në bashkëpunim me IMT Berat. Në kushtet e mungesës së mjeteve për realizimin e ndërhyrjes, po përgatiten materialet e nevojshme për zbatimin e gjithë procedurës ligjore për mbështetje dhe bashkëpunim me firmat private të specializuara në fushën e ndërtimit”.*

---

<sup>4</sup> Referuar shkresës me nr. 698/1 prot., datë 04.02.2021.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së, si dhe legjislacionit përkatës, vërejmë se:

IMT ndjek dhe zbaton hapat ligjorë të parashikuar në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, të ndryshuar, vetëm për ndërtimet pa leje që janë ndërtuar pas datës 27.06.2014 ose janë në proces ndërtimi, pasi për të gjithë ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më datë 27.06.2014, zbatohet ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, i ndryshuar.

Referuar të shkresës me nr. 2966 prot., datë 12.06.2020 të DV ASHK Berat, *inter alia*, ndërtimi informal, mbi ndërtesën/banesën aktuale të ankueses, rezulton të jetë deklaruar me shkresën me nr. 4843 prot., datë 04.12.2014<sup>5</sup>, pra pas datës 27.06.2014.

Neni 4 i ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, parashikon përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, ku ndër të tjera citohet se: “Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse. Për përmbushjen e përgjegjësive të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore.”

Bazuar në “Raportin Teknik/Mbi inspektimin në terren të objektit, banesë private në pronësi të A. B dhe D. B<sup>6</sup>” të Institutit të Ndërtimit, bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vëren se, problematika e ngritur prek jo vetëm subjektin ankues, dhe se ajo është e një grade të tillë sa mund të çojë në kolaps gjithë shpatin dhe ndërtesat përreth shtëpisë së ankueses dhe se, pretendimi i saj për ndërhyrje të KMD-së ndaj institucioneve përkatëse pranë Bashkisë Berat, për zbatimin e Raportit teknik dhe Vendimit të skualifikimit me nr. 3434, datë 12.06.2020 të DV ASHK Berat, sipërcituar, nuk bën pjesë në kompetencat lëndore të KMD-së.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar<sup>7</sup>, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga

<sup>5</sup> Data e ndërtimit të objektit nuk rezulton e dokumentuar në dokumentacionin bashkëlidhur ankesës, ndërsa për shtesat mbi të, ankuesja ka deklaruar vitin 2018.

<sup>6</sup> Ankuesja dhe bashkëshorti/bashkëpronarë të banesës.

<sup>7</sup> Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, ndodhemi përpara rastit, kur ankuesja ka pretenduar për paligjshmëri dhe mosveprim të IMT/Bashkia Berat, pretendim i cili mund të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor, pasi ndodhemi në kushtet e një konflikti të mirëfilltë civil të ankuesit, por dhe banorëve të objekteve/ndërtimeve të tjera të asaj zone me institucionin e IMT/Bashkia Berat, në këtë rast. Pretendimi për paligjshmëri të veprimeve apo mosveprimeve të IMT/Bashkia Berat nuk bën pjesë në kompetencat lëndore të KMD-së<sup>8</sup>.

Përfundimisht, për sa më sipër, bazuar në nenin 33 pika 4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon shprehimisht se, ankesa nuk pranohet nëse: “*është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji*”, çështja e parashtruar nuk mund të shqyrtohet më tej, sepse nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 20/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

---

<sup>8</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 65, datë 22.04.2021 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i publikuar në faqen zyrtare të KMD-së, në linkun: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Vendim-nr.-65-date-22.04.2021-D.-H-kunder-IKMT-dhe-IMT>

## **VENDOSI:**

1. Mospranimin e ankesës së shtetases D. B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Të mira dhe shërbime  
Shkaku: Aftësia e kufizuar, çdo shkak tjetër  
Lloji i vendimit: Mospranim